

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.26.07.2024*

26.07.2024
Ora 11:00

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për përdorimin e kamerave regjistruese dhe të monitorëve për shfaqjen e fletëve të votimit në vendin e numërimit të votave, në zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë, të datës 4 Gusht 2024”.

PJESËMARRJA :

KQZ:

• **Komisioni Rregullator:**

- | | | |
|------------|-------|---|
| • Ilirjana | NANO | Kryetar |
| • Arens | ÇELA | Anëtar |
| • Dritan | ÇAKA | Anëtar |
| • Helga | VUKAJ | Anëtar |
| • Muharrem | ÇAKAJ | Anëtar |
| • Stafi | KQZ | Znj. M.Çelmeta, znj.M.Koja, z.G. Vezuli |

Parti Politike: S’ka prezent

OJQ: KRIIK

Znj. I. Nano: Mirëdita! Fillojmë mbledhjen e Komisionit Rregullator të njoftuar për ditën e sotme në orën 11.00. Në mbledhje janë të pranishëm të gjithë anëtarët e Komisionit Rregullator, Sekretarja e Përgjithshme dhe zyrtarë të tjerë të administratës dhe përfaqësues të shoqërisë civile. Në rendin e ditës të mbledhjes së sotme kemi për të shqyrtuar projektvendimin “Për përdorimin e kamerave regjistruese dhe të monitorëve për shfaqjen e fletëve të votimit në vendin e

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.26.07.2024*

numërimit të votave, në zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë, të datës 4 gusht 2024”. Para se të fillojmë me shqyrtimin e këtij akti do të pyesja kolegët nëse ka çështje jashtë rendit të ditës, që duan të diskutojnë. Kolegë? Nuk ka. Fillojmë me shqyrtimin e projektaktit. Meqenëse ky projektakt ka ardhur si propozim i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve do të kërkoja nga zonja Çelmeta një prezantim të shkurtër të projektaktit dhe të relacionit, faleminderit!

Znj. M. Çelmeta: Faleminderit zonja Nano! Të nderuar anëtarë të Komisionit Rregullator! Fillojmë me relacionin për projektvendimin “Për përdorimin e kamerave regjistruese dhe të monitorëve për shfaqjen e fletëve të votimit në vendin e numërimit të votave, në zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë, të datës 4 gusht 2024”. Pika e parë, “Vlerësimi i ligjshmërisë dhe harmonizimi me legjislacionin në fuqi”. Neni 20, pika 2, shkronja “c” i ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar ka parashikuar kompetencën e Komisionit Rregullator për të shqyrtuar dhe miratuar projektaktet me karakter normativ të përgatitura nga administrata e KQZ-së ose nga anëtarët e tij për përdorimin e sistemeve apo pajisjeve të teknologjisë së informacionit për të mbuluar aspekte apo procedura të veçanta të procesit zgjedhor ose heqjen e tyre nga përdorimi. Neni 22, pika 2, i Kodit Zgjedhor ka parashikuar kompetencat e KQZ-së lidhur me teknologjinë në zgjedhje. KQZ-ja ka kompetencë të instalojë dhe të përdorë sisteme video-monitorimi në qendrat e votimit si dhe të bëhet numërimi manual i votave në VNV-të për të monitoruar dhe provuar rregullshmërinë e procesit në mjediset e brendshme të tyre. Neni 94, pika 4, i Kodit Zgjedhor parashikon se KQZ-ja vendos përdorimin e kamerave regjistruese dhe të monitorëve ose ekraneve për shfaqjen e fletëve të votimit përpara vlerësimit të tyre. Kamerat me rezolucion të lartë instalohen mbi tavolinën e numërimit, në mënyrë të tillë që të bëjnë të


*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.26.07.2024*

mundur regjistrimin e vlerësimit të çdo vote, të çdo flete votimi. Regjistrimi filmik transmetohet në kohë reale në monitor të vendosur përballë vëzhguesve të subjekteve zgjedhore. Regjistrimi filmik i procesit ruhet në media elektronike dhe dorëzohet në KQZ së bashku me materialet e tjera zgjedhore. KQZ-ja ose kur është e mundur edhe KZAZ-ja duhet të riprodhojë kopje të tyre dhe t'i vërë në dispozicion të subjekteve zgjedhore kundrejt pagesës së një tarife që mbulon koston e riprodhimit. Pika 2: “Përmbledhje shpjeguese e përmbajtjes së projektvendimit”. Në zbatim të detyrimeve të ligjit numër 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në këtë projektvendim parashikohet që në zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë të datës 4 gusht 2024, të përdoren kamera regjistruese dhe monitorë ose ekrane për regjistrimin dhe shfaqjen e fletëve të votimit në çdo vend të numërimit të votave. Gjithashtu do të përdoren sistemet e transmetimit video në kohë reale të monitorimit të numërimit të votave nga çdo vend i numërimit të votave, në ambientet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Projektvendimi parashikon se përdorimi i kamerave regjistruese e monitorëve ose ekraneve dhe sistemeve të transmetimit, video në kohë reale nga çdo vend i numërimit të votave në ambientet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve do të bëhet në bazë të rregullave procedurale të miratuara me akt normativ të Komisionit Rregullator. Ngarkohet me përgjegjësi për zbatimin e këtij projektvendimi administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Për sa më sipër në këtë relacion, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve i propozon Komisionit Rregullator për shqyrtim dhe miratim projektvendimin “Për përdorimin e kamerave regjistruese dhe të monitorëve për shfaqjen e fletëve të votimit në vendet e numërimit të votave në zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë, të datës 4 gusht 2024”. Faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.26.07.2024*


Znj. I. Nano: Faleminderit zonja Çelmeta! Ka ndonjë pyetje për administratën? Jo. Fillojmë me shqyrtimin në parim të projektvendimit. Kolegë? Kush dëshiron ta marrë fjalën? Zonja Vukaj!

Znj. H. Vukaj: Të nderuar qytetarë! Të nderuar pjesëmarrës këtu në sallë! Për hir të transparencës përvijuese do të ndalesha në një rezymë të shkurtër. Edhe ky akt është në vazhden e aktit sipar, atij 69, por kemi një risi, të cilën gjykata e ka marrë përsipër, Kolegji Zgjedhor më saktë, tashmë kemi një fletë votimi. Njëkohësisht, paralelisht me Kolegjin Zgjedhor, i cili miratoi specifikimet teknike të fletës, që do të thotë ky proces është aktiv. Kemi dhe vendimin e Gjykatës, e cila vlerësoi të mos vendoste masë sigurie mbi dekretin e Presidentit dhe kjo më bën që unë të jem gjithëpërfshirëse në vlerësimin dhe shqyrtimin më tej të këtij akti, me qëllim rritjen e elementëve të garancisë, sigurisë, transparencës për votën tuaj të datës 4 gusht 2024. Kështu që për sa kohë ky akt i përket një procedure transparence dhe sigurie, personalisht do të vijoj të vlerësoj dhe të shqyrtoj më tej aktin. Faleminderit!

Znj. I. Nano: Faleminderit zonja Vukaj! Po, zoti Çakaj!

Z. M. Çakaj: Po, faleminderit e nderuar! Atëherë, ju e dini tashmë qëndrimin tonë, që kemi mbajtur për dy aktet pararendëse. Me dekretin numër 244, datë 5.07.2024, Presidenti i Republikës ka caktuar datën e zgjedhjeve për Kryetar Bashkie në Himarë. Në mbledhjen e parë të zhvilluar nga ky Komision Rregullator për caktimin e disa afateve proceduriale, duke qenë se nuk i parashikon Kodi Zgjedhor për zgjedhjet e pjesshme, normalisht kompetenca për caktimin e këtyre afateve proceduriale ishte e Komisionit Rregullator. Në këto kushte, u vijua, u propozuan nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pra u propozua me një akt përcaktimi i disa

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.26.07.2024*

afateve. Qëndrimi jonë ka qenë kundra, për arsye se akti, vendimi numër 69 i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, në gjykimin tim, besoj dhe në gjykimin e koleges Vukaj, ka qenë, është dhe për sa kohë deri në datën 5 gusht, parashikohet afati i ankimimit, pra afati 30 ditor. Për sa kohë jemi brenda afatit të vlefshmërisë, vendimi është i ankimueshëm, pra nuk mund të zbatohet. Megjithatë, ne kemi një akt, i cili ishte dekreti 244 i Presidentit dhe në mbledhjen e parë, ne kemi kërkuar që të paktën të kishim një verifikim ligjshmërie nga një organ gjyqësor, qoftë edhe një vendim për marrjen ose mosmarrjen e masës së sigurimit të padisë dhe siç dihet ishte fakt që “Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut”, e kishte ankimuar këtë vendim në Gjykatën Administrative. Vetëm në datën 22.07.2024, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë, me vendimin 92 79 ka disponuar për rrëzimin e sigurimit të padisë, së pari kjo. Së dyti, palët të cilat kanë shprehur interes për të marrë pjesë, qoftë mazhoranca, qoftë opozita, me veprimet e tyre proaktive kanë treguar, që pavarësisht vendimeve të cilat janë apo s’janë, apo hanë debat për ligjshmërinë e tyre apo pavleftshmërinë e tyre, kanë treguar me veprimë aktive që duan të marrin pjesë në këtë proces zgjedhor. Atëherë, në këto kushte, Kodi Zgjedhor ka parashikuar, që ne si Komision Rregullator përcaktojmë rregullat, që palët në fund të ditës të marrin pjesë dhe të garojnë me njëra-tjetrën. Në këto kushte, duke qenë në këtë situatë ligjore, unë vlerësoj që duhet ta shqyrtojmë, pra në parim jam dakord, dhe duhet ta shqyrtojmë këtë projektakt në tërësi, pra nen për nen e më pas në tërësi. Faleminderit e nderuar!

Znj. I. Nano: Faleminderit zoti Çakaj! Kolegë? Edhe unë sa i përket diskutimit në parim kam të njëjtin qëndrim të mbajtur edhe në mbledhjet e mëhershme të Rregullatorit. Kam votuar pro në parim projektakteve duke i konsideruar si të domosdoshme për një proces zgjedhor të pritshëm me datën 4 gusht. Nga ana tjetër

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.26.07.2024*

aktet kanë qenë të gjitha, ato që kanë ardhur, projektaktet kanë qenë kompetencë e Komisionit Rregullator. Për më tepër, për këtë akt, në më herët, në zgjedhjet e shkuara, kemi miratuar rregullat proceduriale për përdorimin e kamerave, ndërkohë që akti i përdorimit, pra i vendosjes së përdorimit të kamerave miratohet rast pas rasti, sa herë që kemi zgjedhje. Nëse nuk kemi diçka tjetër në parim, kalojmë në votimin në parim të projektvendimit.

Kush është dakord kolegë?

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. D. Çaka, z. A. Çela, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s'ka!

Miratohet në parim me pesë vota pro!

Kalojmë në shqyrtimin nen për nen të projektvendimit, ose pikë për pikë.

Pika 1, me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisioni Rregullator vendosi:

- Përdorimin e kamerave regjistruese dhe të monitorëve, ekraneve për regjistrimin dhe shfaqjen e fletëve të votimit në vendin e numërimit të votave në zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë, të datës 4 gusht 2024.

Kolegë?


Znj. H. Vukaj: Një pyetje për administratën.

Znj. I. Nano: Po, zonja Vukaj!

Znj. H. Vukaj: Kamerat janë në gjendje apo do të prokurohen?

Znj. M. Çelmeta: Kamerat janë në gjendje.

***Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU***



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.26.07.2024*

Znj. H. Vukaj: Janë testuar, domethënë?

Znj. M. Çelmeta: Patjetër.

Znj. I. Nano: Po, pyetje të tjera? Nuk ka. Kalojmë në votimin e pikës 1.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. D. Çaka, z. A. Çela, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s'ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Pika 2. Përdorimin e sistemit të transmetimit video në kohë reale të monitorimit të numërimit të votave nga vendi i numërimit të votave në ambientet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë, të datës 4 gusht 2024.

Kolegë? Nuk ka diçka. Kalojmë në votimin e pikës 2.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. D. Çaka, z. A. Çela, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s'ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Pika 3. Përdorimi i kamerave regjistruese e monitorëve (ekranëve) dhe sistemi i transmetimit video në kohë reale nga vendi i numërimit të votave në ambientet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve do të bëhet në bazë të rregullave procedurale të miratuara me akt normativ të Komisionit Rregullator.

Kolegë? Zoti Çakaj!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.26.07.2024*

Z. M. Çakaj: Po, në dijeninë time, në rregullat proceduriale që kemi miratuar me aktin pararendës, kamerat regjistruese janë dhe video dhe audio, në mos gaboj. Kjo është? Pra, e konfirmoni këtë gjë?

Znj. H. Vukaj: Ruhet i njëjti standard i kamerave si edhe më përpara?

Z. G. Vezuli: Është i njëjti standard i kamerave që ka qenë.

Z. M. Çakaj: Pra, video dhe audio?

Z. G. Vezuli: Po, video dhe audio.

Z. M. Çakaj: Dakord.

Znj. H. Vukaj: Është testuar dhe ky sistemi nga KQZ-ja, i monitorimit dhe i përcimit në kohë reale, gjithçka është testuar?

Znj. M. Çelmeta: Patjetër që po.

Znj. H. Vukaj: Dakord.


Znj. I. Nano: Faleminderit! Pyetje të tjera? Nuk ka. Kalojmë në votimin e pikës 3.
Kush është dakord, kolegë?

Pro: 5 (z. I. Nano, z. D. Çaka, z. A. Çela, z. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s'ka!

Me 5 vota pro, miratohet!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.26.07.2024*

Pika 4. Ngarkohet administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për zbatimin e këtij vendimi.

Kush është dakord?

Pro: 5 (zgj. I. Nano, z. D. Çaka, z. A. Çela, zgj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s'ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Kush është dakord?

Pro: 5 (zgj. I. Nano, z. D. Çaka, z. A. Çela, zgj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s'ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Kush është dakord?

Pro: 5 (zgj. I. Nano, z. D. Çaka, z. A. Çela, zgj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s'ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Pasi kemi votuar në parim dhe nën për nën projektvendimin, kalojmë në votimin në tërësi të projektvendimit. Edhe njëherë kolegë ju ftoj të votoni.

Kush është dakord në tërësi me projektin?

Pro: 5 (zgj. I. Nano, z. D. Çaka, z. A. Çela, zgj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s'ka!

Miratohet!

Atëherë, meqenëse nuk kemi çështje të tjera në rendin e ditës apo jashtë rendit të ditës për të diskutuar, mbledhjen...

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.26.07.2024*

Znj. H. Vukaj: Për saktësi të lutem! Para se ta mbyllim, të lutem, do të preferoja që faqja fundore të integrohej, të përfshihej në faqen pararendëse.

Znj. I. Nano: Mos të mbeten vetëm emrat në fund. Po, gjatë formatimit të bëhet.

Znj. H. Vukaj: Dhe një kërkesë kam, më duhet të më vihen në dispozicion, procesverbalet e mbledhjes të mbajtura në dy herët e kaluara, për shkak se në referimin që i bëra apo për sa lexova vendimet e gjykatës, ishin marrë përciptazi dhe dua të di nëse gjykata e ka përdorur përciptazi apo ashtu është në përmbajtje? Unë nuk dyshoj që është ashtu në përmbajtje, por për saktësim më duhet të di.

Znj. I. Nano: Faleminderit! Mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

Vendimi nr. 04

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

